



Pranuar / Dorezuar Punjseno/Prodato Received/Delivered	26.04.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Nr Prot Prot No	Shtojta Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANSI	2432/2022		115



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

**A.nr.227/2022**

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca-anëtarë, dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.227/2022 të datës 11.03.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë rruga kundër Vendimit me Nr. 13-116/01-0012683/22 të datës 22.02.2022 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Podujevës, në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 26.04.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

- I. **APROVOHET si e bazuar** ankesa me numër A.nr.227/2022 e datës 11.03.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. **SHFUQIZOHET** Vendimi me Nr. 13-116/01-0012683/22 i datës 22.02.2022 i Komisionit Disiplinor të Komunës së Podujevës.
- III. **OBLIGOHET** Kryetari i Komunës dhe Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Podujevës, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimi të tij, duke bërë shuarjen e masës disiplinore ndaj ankuesit në pajtim me këtë vendim dhe dispozitat ligjore në fuqi, si dhe kompensimin e pagës në vlerën 20% për dy muaj të ndaluar sipas vendimit si në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

## A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Komunën e Podujevës, fizikisht më datë 10.03.2022 ka parashtruar ankesë me Nr. Prot: 1302/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr. 13-116/01-0012683/22 të datës 22.02.2022 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Podujevës.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova:** Ankesën e datës 10.03.2022 e regjistruar me Nr. Prot:1302/2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimi LRP.Nr.2335/2022; Vendimin me Nr. 13-116/01-0012683/22 të datës 22.02.2022 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Podujevës; Vendimin A.n.1216/2021 të datës 07.02.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesën e datës 23.12.2021 e regjistruar me Nr. Prot:6312/2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizim i datës 23.12.2021; Kërkesë për fillimin e procedurës disiplinore e datës 02.12.2021; Ftesën për seancë disiplinore e datës 08.12.2021; Vendimin me Nr. 13-116/01-0107913/21 të datës 14.12.2021 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Podujevës; Procesverbal i deklaramit në seancë dëgjimore i datës 10.12.2021 i nënshkruar nga ankuesi; Publikimet e ankuesit në rrejtët sociale FACEBOOK të datës 16.10.2021, 18.11.2021, 25.10.2021, 10.10.2021, 25.11.2021, 20.11.2021, 27.11.2021, 18.11.2021, 23.11.2021; Postim nga Komuna e Podujevës i datës 29.09.2021, 06.10.2021, 07.10.2021, 11.10.2021, 28.10.2021, 03.12.2021; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 29.12.2021; Përgjigjen në ankesë e datës 19.01.2022; Akt Emërimit e datës 01.04.2015 në emër të ankuesit; Fletë dorëzimi i datës 08.12.2021; Ftesë për seancë dëgjimore për Kryetarin e Komunës së Podujevës e datës 08.12.2021; Procesverbal i seancës dëgjimore të Komisionit Disiplinor i datës 10.12.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesit, **është e bazuar, sepse:**

Bazuar në shkesat e lëndës, gjegjësisht Akt Emërimit e datës 01.04.2015 është konstatuar se ankuesi është i punësuar në pozitën e punës *Zyrtar i Lartë për Komunikim me Publikun* në Komunën e Podujevës. Kryetari i Komunës së Podujevës, me datë 02.12.2021 ka paraqitur kërkesë për fillimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit me arsyetimin se i njëjti gjatë fushatës zgjedhore ka bërë propagandë dhe ka shprehur përkrahje ndaj subjektit dhe kandidatit të caktuar politik përmes rrjetit social facebook, gjatë orarit të punës.

Komisioni Disiplinor pranë Komunës së Podujevës, pas shqyrtimit të rastit, me datë 14.12.2021 ka nxjerr Vendimin me Nr.13-116/01-0107913/21 përmes të cilit e ka shpallur përgjegjës ankuesin dhe të njëjtit i ka shqiptuar masën disiplinore *“Ndalim i 20% të pagës për një periudhë prej 2 muaj”*.

Ankuesi, kundër Vendimit me Nr.13-116/01-0107913/21 të datës 14.12.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se Komisioni Disiplinor ka nxjerr vendim të kundërligjshëm për faktin se të gjitha postimet kanë qenë në llogarinë e tij private, jashtë orarit zyrtar të punës dhe ditëve të vikendit, pa

asnjë tendencë anshmërie dhe i njëjti pretendon se lejohet sipas dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 07.02.2022 ka nxjerr Vendim A.nr.1216/2021, me të cilin ka aprovuar ankesën e ankuesit të datës 23.12.2021 duke e shfuqizuar Vendimin me Nr. 13-116/01-0107913/21 të datës 14.12.2021 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Podujevës dhe duke e obliguar Komisionin Disiplinor të rishqyrtoj rastin e ankuesit.

Komisioni Disiplinor i Komunës së Podujevës, më datë 22.02.2022 ka rishqyrtuar rastin e ankuesit sipas Vendimit me A.nr.1216/2021 të datës 07.02.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe ka nxjerr Vendim me Nr. 13-116/01-0012683/22, me të cilin ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore "*ndalimi i 20% të pagës për periudhën 2 muaj*".

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin me Nr. 13-116/01-0012683/22 të datës 22.02.2022 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Podujevës, me datë 11.03.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër pretendon që Komisioni Disiplinor ka vendosur në kundërshtim me legjislacionin në fuqi për shkak që i është referuar dy postimeve të mia e të cilat janë bërë jashtë orarit zyrtar të punë dhe vikendeve.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, lidhur me shqyrtimin e ligjshmërisë se pretendimeve ankimore të ankuesit ka analizuar Vendimin me Nr. 13-116/01-0012683/22 të datës 22.02.2022 të Komisionit Disiplinor, dhe rrjedhimisht ka gjetur se Komisioni Disiplinor ka konstatuar se ankuesi në llogarinë e tij personale në facebook ka publikuar postime ku shihet qartazi se i njëjti ka bërë fushatë elektorale në përkrahje të subjektit politik dhe kandidatit për kryetar të Komunës, prandaj Komisioni veprimet e ankuesit i cilëson si aktivitete politik në kuptim të dispozitave të Ligjit për Zyrtarët Publikë. Sipas Komisionit Disiplinor ankuesi këto postime i ka bërë në detyrat dhe funksionet e tij si Zyrtar i lartë për Komunikim me Publikun në Komunën e Podujevës. dhe me këto veprime ka bërë shkelje të nenit 22 paragrafi 1 dhe nenin 25 paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenin 5 të Rregullores (QRK) Nr.04/2015 për Kodin e Mirësjelljes në Shërbimin Civil, dhe nenin 4 të Kodit të Etikes për Zyrtarët e Komunës së Podujevës. Rrjedhimisht Komisioni Disiplinor konstaton se ankuesi ka kryer shkelje të rendë nga neni 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.8 të Ligjit për Zyrtarët Publikë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, lidhur me këtë çështje ju ka referuar dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 2 paragrafi 2 ku përcaktohet se: 2. Zyrtarë publikë janë: 2.1. nëpunësi i Shërbimit Civil (në tekstin në vijim: nëpunësi civil); 2.2. nëpunësi i Shërbimit Publik; 2.3. nëpunësi i Kabinetit; dhe 2.4. nëpunësi administrativ dhe mbështetës, dhe nenit 22 paragrafi 1 të këtij ligji, ku përcaktohet se: *Zyrtari publik ka të drejtë të marrë pjesë në aktivitete politike vetëm jashtë orarit zyrtar të punës dhe jashtë ambienteve të institucioneve publike*, dhe në kuptim të kësaj dispozite ligjore Kolegji, konstatoi se nëpunësit civil nuk i ndalohet pjesëmarrja në aktivitete politike jashtë orarit zyrtar të punës dhe jashtë ambienteve të institucionit ku punon. Në kuptim të kësaj Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar të gjitha dëshmitë respektivisht postimet e ankuesit të publikuara në rrjetin social facebook, dhe ka konstatuar që ankuesi postimin e datës 10.10.2021 e ka bërë në ditë vikendit (e diele), postimin e datës 16.10.2021 e ka bërë në ditë vikendi (e shtunë), postimin e datës 25.10.2021 e ka bërë pasdite në orën 09:44 PM, postimin e datës 18.11.2020 e ka



bërë pasdite në orën 10:56 PM, postimin e datës 20.11.2021 e pa bërë në ditë vikendit (shtunë), postimin e datës 23.11.2021 e ka bërë pas ditë në orën 10:01 PM; postimin e datës 25.11.2021 e ka bërë pas ditë në orën 8:56 PM, postimin e datës 27.11.2021 e ka bërë pas ditë në orën 10:15 PM.

Andaj, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Komisioni Disiplinor i Komunës së Podujevës me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr. 13-116/01-0012683/22 të datës 22.02.2022, me të cilin i ka shqiptuar ankuesit masën disiplinore *"ndalimi i 20% të pagës për periudhën 2 muaj"*, ka vepruar në kundërshtim me nenin 11 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik, i cili përcakton se **"Komisioni disiplinor ka këto kompetenca: 1.1; Bënë shqyrtimin e fakteve dhe provave të paraqitura" dhe 1.2. Përcakton dhe shqipton masën disiplinore"**, sepse nuk ka arritur të vërtetojë drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, gjegjësisht nuk ka arritur të konstatoj me dëshmi konkrete se ankuesi i ka kryer shkeljet e pretenduara nga inicuesi, po ashtu nuk ka konstatuar sakte datën, orën dhe përmbajtjen e postimit të publikuar, respektivisht nuk ka arritur të konstatoj saktë se postimet e bëra nga ankuesi kanë qenë brenda apo jashtë orarit zyrtar të punës, e që sipas Vendimit A.n.1216/2021 të datës 07.02.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Komisionit Disiplinor e ka pasur për obligim të vërtetojë. Bazuar në këtë Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, vlerëson se meqenëse se zyrtarit publik ka të drejtë të marrë pjesë në aktivitete politike vetëm jashtë orarit zyrtar të punës dhe jashtë ambienteve të institucioneve publike, atëherë Komisioni Disiplinor i Komunës së Podujevës gabimisht ka vlerësuar që ankuesi ka dëmtuar reputacionin e Komunës së Podujevës, sepse nuk ka konstatuar se a janë përmbushur elementet e përgjegjësisë disiplinore siç parashihet me nenin 45 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *"Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit"*, elemente këto që duhet plotësuar kumulativisht në mënyrë që të ekzistoj përgjegjësia disiplinore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se Komisioni Disiplinor i Komunës së Podujevës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr. 13-116/01-0012683/22 të datës 22.02.2022, me të cilin i ka shqiptuar ankuesit masën disiplinore *"ndalimi i 20% të pagës për periudhën 2 muaj"*, ka vepruar në kundërshtim me nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, nenin 50 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2, paragrafin 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenin 11, 12, dhe nenin 13 paragrafin 3, 4 dhe 5 të Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, sepse nuk ka arritur saktë të konstatoj se ankuesi me postimet e tij në rrjetin social facebook ka bërë shkelje të nenit 22 dhe 25 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, kështu që Vendimi me Nr. 13-116/01-0012683/22 i datës 22.02.2022 i Komisionit Disiplinor i Komunës së Podujevës, është në kundërshtim edhe me nenin 48 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe në këtë rast i njëjti është i paligjshëm në kuptim të nenit 52 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3, 1.5, 1.6 dhe 1.7 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, rrjedhimisht pretendimet e ankuesit i cili pretendon se Komisioni Disiplinor ka vendosur në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, janë të bazuara.

Meqenëse Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstatoj se Vendimi me numër Nr. 13-116/01-0012683/22 të datës 22.02.2022, i Komisionit Disiplinor i Komunës së Podujevës është

i paligjshëm. atëherë Kryetari i Komunës së Podujevës dhe Menaxheri i Personelit, janë të obliguar që të bëjnë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi, duke bërë shuarjen e masës disiplinore nga dosja personale e ankuesit, si dhe të bëjë kompensimin e pagës së ndaluar për muajt e përcaktuar në vendim të Komisionit Disiplinor.

Me dispozitat e nenit 21 paragrafit 1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është përcaktuar se: ***“Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës”***, ndërsa me dispozitat e nenit 24 paragrafit 1 të këtij ligji është përcaktuar se: ***“Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit sipas nenit 21 të këtij ligji, Kryetari i Këshillit nxjerr vendim për ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit”***.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit-prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.227/2022

Avdyl BEKTESHI



Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Podujevës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Podujevës dhe;
- Arkivit të KPMSHC'K-së.

